



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



ZYRA E PËRMBARRIMIT PRIVAT "ASTREA"

Nr.1790 Prot

Tiranë, më 26.07.2021

Nr.111-21 Regj.

URDHËR

PËR HEQJEN E MASËS SË SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar : Qendrës Kombëtare e Biznesit

TIRANË

Për dijëni: Debitorit – Shoqëria "Super Foods" Shpk me NIPT M01310010L

Administratorit – Gerald Engjell Lamaj i dtl.03.12.1989

Adresa: Tiranë, Rruga "Siri Kodra", ish Frigoriferi, Kutia Postare nr.149, Njësia Bashkiake nr. 8.  
Telefon: 0692040314

Për dijëni: Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit Tiranë

Adresa: Tiranë

Për dijëni: Kreditorit – Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU)

Adresa: Rr. "Stavri Themeli", 1000, Tiranë.

Unë, Klodjana Çeliku, Përmbartes Gjyqësor pranë Zyrës së Përmbarrimit Privat "ASTREA" shpk Nipt: L61306025U, në referim të Urdhërit të Ekzekutimit Nr.740, datë 23.02.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarrimore Nr.111-21, datë 25.06.2021 kërkesën e kreditorit Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) ndaj debitorit Shoqëria "Super Foods" Shpk me NIPT M01310010L dhe administrator Gerald Engjell Lamaj, në lidhje me Titullin Ekzekutiv Aktin Administrativ "Procesverbal Inspektimi dhe Vendim Përfundimtar" Nr.Serial Nr.AKU-TR-2020-004541-2-5, datë 23.07.2020 dhe Serial Nr.AKU-TR-2020-004195-2-5, datë 14.07.2020.

Pasi fillova procesin e ekzekutimit të detyrueshëm, duke i dërguar debitorit Lajmërimin Nr.1523 Prot, Datë 28.06.2021, për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin që përmban Urdhëri i Ekzekutimit Nr.740, datë 23.02.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në referim të neneve 517 dhe 518 të K.Pr.Civile, kam kaluar ne Venie Sekuestro mbi pasuritë e tij.

Adresa: Rr. "Kajo Karafil", Pallati pas Lidhjes të Shkrimtarëve, Hyrja 1, Kati 2, Zyra nr.6, Tiranë Cel  
+355 676950155  
e-mail : sherbimipermbarrimorastrea@gmail.com



Lidhur sa më sipër, duke zhvilluar dhe kryer veprimet procedurale të nevojshme për ekzekutimin e plotë të titullit ekzekutiv me palët e lartpërmendura,

**KONSTATOVA:**

Me urdhër Nr.1675 Prot, Datë 12.07.2021 është Urdhëruar Vendosia e Sekuestros Konservative pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në aktivet e debitorit Shoqëria “Super Foods” Shpk me NIPT M01310010L.

Nga ana e palës debitore Shoqëria “Super Foods” Shpk me NIPT M01310010L me adm. Gerald Engjell Lamaj u shlye e gjithë vlera e detyrimit në llogarinë e Zyrës së Përmbarrimit Privat “ASTREA” shpk Nipt: L61306025U, pranë BKT Bank Sha.

Në këto kushte, në zbatim të nenit 616 Pika (a), nenit 617 të Kodit të Procedurës Civile dhe Ligjit Nr. 26/2019 miratuar më datë 08.05.2019 “Për Shërbimin Përmbarrimor Gjyqësor Privat”,

**URDHËROJ:**

1. ***Heqjen e masës së Sekuestros Konservative***, të vendosur me anë të Urdhërit Nr.1675 Prot, Datë 12.07.2021 në aktivet e debitorit:

- **Shoqëria “Super Foods” Shpk me NIPT M01310010L.**

Lidhur sa më sipër, duke e konsideruar këtë urdhër të plotë dhe konform kërkesave të ligjit, Ju bëj me dije se:

- a) Personat që bëhen pengesë për zbatimin dhe realizimin e tij, do të përgjigjen sipas dispozitave që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
- b) Kundër detyrimit që përcakton ky urdhër, i cili është një veprim procedural përmbarrimor i referuar në K.Pr.Civile dhe Udhëzimin Nr. 2 datë 27.03.2014 të Bankës së Shqipërisë, palët mund të paraqesin ankim në Gjykatë, brenda 5 (pesë) ditëve.
- c) Ky urdhër mbahet në 4 (katër) kopje.

**ZYRA E PËRMBARRIMIT PRIVAT “ASTREA”  
PËRMBARRUESI GJYQËSOR**

**KLODJANA ÇELIKU**

